

PROCEDURAT E PROVIMIT

Provimi i Maturës organizohet më 9 dhe 23 qershor 2012;

Paraqitja e Provimit të Maturës bëhet më 14 - 31 maj 2012;

Provimi mbahet në Qendrat e Testimit, të cilat i cakton DKA/MASHT;

Lista me emrat e maturantëve dhe Qendrat e Testimit do të jetë në drejtorinë e shkollës së mesme të lartë që sapo e keni përfunduar;

Të dy pjesët e Provimit të Maturës organizohen në datat e caktuara më lart dhe fillojnë në orën 10:00, ndërsa maturantët duhet të jenë në orën 8:30 te Qendrat e Testimit;

Provimi zgjat 180 minuta, pa e llogaritur kohën e shpërndarjes së testeve dhe kohën e udhëzimeve teknike, të cilat do t'i merrni nga administruesit e Testit. Pra, Testimi fillon në orën 10:00 dhe përfundon në orën 13:20;

Veproni sipas udhëzimeve të administruesit të Testit;

Plotësoni me kujdesë Broshurën e Testit e, sidomos Fletëpërgjigjen;

Pagesa për Provimin e Maturës Shtetërore është 5 € (pesë euro) dhe bëhet në Bankë, me Fletëpagesë që merret në drejtorinë e shkollës, me nr. të xhirologarisë

KRITERET E PROVIMIT TË MATURËS

- 1** Provimi i Maturës Shtetërore organizohet në dy ditë. Në ditën e parë nxënësit do t'i nënshtrohen provimit nga lëndët e përgjithshme, ndërsa në të dytën, nga lëndët profesionale, sipas profileve përkatëse;
- 2** Të drejtën e Provimit të Maturës Shtetërore do ta kenë nxënësit që e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme të lartë, si dhe Provimin Përfundimtar, për arsimin profesional;
- 3** Kriteri i kalueshmërisë në provimin e maturës është 50% nga rezultati i përgjithshëm i testit, duke përfshirë atë të ditës së parë dhe të dytë;
- 4** Kandidati që e arrin kriterin e kalimit, 50% e më shumë, shpallet i diplomuar i shkollës së mesme të lartë, dhe pajiset me **DIPLOMË** të maturës dhe fiton të drejtën e pjesëmarrjes në konkurrim për studime Universitare;
- 5** Maturantët që nuk mund ta arrijnë kriterin e kalimit, 50% në këtë afat, do të kenë të drejtë t'i nënshtrohen Provimit të Maturës në afatet vijuese;
- 6** Për pranim në universitet llogariten : 80 % e pikëve nga rezultati i Testit të Maturës dhe 20% nga suksesi në shkollën e mesme të lartë, për ato njësi akademike të cilët i pranojnë kandidatet pa provim pranues, ndërsa për ato njësi akademike të cilët i organizojnë provimet pranuese, pikët llogariten 50% nga rezultati i Testit të Maturës, 20% nga suksesi i arsimit të mesëm të lartë dhe 30% nga provimi i pranues në njësi akademike.

Fakultet në të cilat është eliminuar provimi pranues janë:
FShMN, Bujqësi dhe Veterinari, Inxhinieri mekanike,
Inxhinieri elektrike dhe kompjuterike, Gjeoshkencë dhe Teknologji,
FSHTA-Ferizaj dhe FSHTA-Mitrovicë
Sqarimet më të hollësishme maturantët do të marrin me rastin e shpalljes së konkursit për regjistrim në Universitet.

MODELI I TESTIT

-Testi përmban kërkesa (pyetje) të tipit të mbyllur, me zgjidhje të shumëfishta, me katër alternativa, nga të cilat vetëm njëra është e saktë.

Dita e parë: -Testi përmban 120 kërkesa (pyetje) nga lëndët e përgjithshme, Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Matematikë .

Dita e dytë: -Testi përmban 80 kërkesa (pyetje) nga lëndët e profilit përkatës arsimor.

TIPI I SHKOLLËS DHE PROFILI ARSIMOR:

I. Gjimnazi Matematikë – Informatikë

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 50 kërkesa
2. Gjuhë angleze 30 kërkesa
3. Matematikë 40 kërkesa

Dita e dytë

1. Matematikë 30 kërkesa
2. Fizikë 20 kërkesa
3. Kimi 15 kërkesa
4. Biologji 15 kërkesa

II. Gjimnazi i Shkencave natyrore

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 50 kërkesa
2. Gjuhë angleze 30 kërkesa
3. Matematikë 40 kërkesa

Dita e dytë

1. Matematikë 10 kërkesa
2. Fizikë 20 kërkesa
3. Kimi 25 kërkesa
4. Biologji 25 kërkesa

III. Gjimnazi i Shkencave shoqërore

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 60 kërkesa
2. Gjuhë angleze 30 kërkesa
3. Matematikë 30 kërkesa

Dita e dytë

1. Histori 30 kërkesa
2. Gjeografi 15 kërkesa
3. Sociologji 25 kërkesa
4. Psikologji 10 kërkesa

IV. Gjimnazi Gjuhësor

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 60 kërkesa
2. Gjuhë angleze 40 kërkesa
3. Matematikë 20 kërkesa

Dita e dytë

1. Gjuhë shoqe 10 kërkesa
2. Gjuhë e dytë e huaj 20 kërkesa
3. Histori 25 kërkesa
4. Sociologji 25 kërkesa

V. Gjimnazi i Përgjithshëm

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 50 kërkesa
2. Gjuhë angleze 30 kërkesa
3. Matematikë 40 kërkesa

Dita e dytë

1. Shkenca natyrore 50 kërkesa
(Fizikë 16, Kimi 17, Biologji 17)
2. Shkenca shoqërore 30 kërkesa
(Histori 15, Gjeografi 15, Sociologji 10)

VI. Arsimi Profesional I.

(Shëndetesi, Bujësi, Hortikulturë, Teknologji ushqimore, Kimi – teknologji, Geologji)

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 60 kërkesa
2. Gjuhë angleze 30 kërkesa
3. Matematikë 30 kërkesa

Dita e dytë

1. Kimi 25 kërkesa
2. Biologji 25 kërkesa
3. Informatikë 15 kërkesa
4. Ekonomi me ndërmarrësi 15 kërkesa

VII. Arsimi Profesional II.

(Elektronikë, Komunikacion, Ndërtimtar, Gjeodezi, Grafikë, Tekstil, Xehetari)

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 50 kërkesa
2. Gjuhë angleze 30 kërkesa
3. Matematikë 40 kërkesa

Dita e dytë

1. Matematikë 25 kërkesa
2. Fizikë 15 kërkesa
3. Informatikë 20 kërkesa
4. Ekonomi me ndërmarrësi 20 kërkesa

VIII. Arsimi Profesional III.

(Administratë, Ekonomi, Hoteleri, Turizëm, Postë – telefon)

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 60 kërkesa
2. Gjuhë angleze 30 kërkesa
3. Matematikë 30 kërkesa

Dita e dytë

1. Ed. Qytetare 25 kërkesa
2. Informatikë 20 kërkesa
3. Ekonomi me ndërmarrësi 35 kërkesa

IX. Arsimi Profesional IV.

(Muzikë)

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 60 kërkesa
2. Gjuhë angleze 30 kërkesa
3. Matematikë 30 kërkesa

Dita e dytë

- Histori e muzikës dhe harmoni 25 kërkesa
- Intervalet dhe akordet 25 kërkesa
- Teori e muzikës, ritmet dhe masat 30 kërkesa

X. Arsimi Profesional V.

(Art)

Dita e parë

1. Gjuhë amtare 60 kërkesa
2. Gjuhë angleze 30 kërkesa
3. Matematikë 30 kërkesa

Dita e dytë

1. Histori e artit 30 kërkesa
2. Teori e formës 30 kërkesa
3. Informatikë 20 kërkesa

DATA ME RËNDËSI

- Mësimi për maturantë përfundon më **18 maj 2012**
- Riprovimet mbahen më **24 -25 maj 2012**
- Provimi përfundimtar, më **29-30 maj 2012**
- Rezultatet e Provimit përfundimtar, më **31 maj 2012**
- Paraqitja e Provimit të Maturës Shtetërore më **14-31 maj**
- Dorëzimi i shënimeve përfundimtare, më **1 qershor 2012** me listë të nxënësve dhe me Qendra të Testimit
- Provimi i Maturës Shetërore, Dita e parë, më **9 qershor 2012**
- Provimi i Maturës Shetërore, Dita e dytë, më **23 qershor 2012**
- Publikimi i rezultateve, më **30 qershor 2012**
- Ankesat e nxënësve, më **2-4 korrik 2012**
- Publikimi i rezultateve të ankesave, më **5 korrik**








- Paraqitja e provimit të maturës bëhet në drejtorinë e shkollës dhe evidentohet në fletore të posaçme, me numër protokolli, me dokumente të nevojshme dhe me dëshmi për pagesë.
- Kandidatët që nuk e paraqesin me kohë Provimin e Maturës Shtetërore, konsiderohet se kanë hequr dorë nga provimi.
- Kandidatët e kthyer nga bota e jashtme paraqiten në MASHT – DVSM, verifikojnë suksesin e pastaj caktohen se ku duhet t'i nënshtrohen Provimit të Maturës, më së largu deri më 31 maj 2012.

Afati i Gushtit

- Riprovimet dhe provimi përfundimtar mbahen më **21 - 23 gusht 2012**
- Paraqitja e Provimit të Maturës Shtetërore, më **20 – 23 gusht 2012**
- Provimi i Maturës Shetërore, Pjesa e parë, më: **31 gusht 2012**
- Provimi i Maturës Shetërore, Pjesa e dytë, më: **8 shtator 2012**
- Publikimi i rezultateve, më **17 shtator 2012**
- Ankesat e nxënësve, më **17-20 shtator 2012**








ÇFARË NË DITËN E PROVIMIT?

Maturantëve u lejohe:

-  Të jenë të pranishëm në Qendrën e Testimit, një orë e gjysmë para fillimit të testimit;
-  Të kenë me vete letërnjoftimin;
-  Të hyjnë brenda në kohën e caktuar, pas apelit të personit të autorizuar;
-  Të ulen sipas udhëzimeve të administruesit / personit të autorizuar;
-  Të kenë me vete një laps grafit, HB.
-  Të kenë me vete një shishe me ujë të pijes;
-  Të plotësojnë me kujdes të gjitha të dhënat në Fletëpërgjigje.



Maturantëve nuk u lejohe:

-  Të vonohen në provim
-  Të kenë celular apo ndonjë mjet tjetër për komunikim gjatë testimit;
-  Të ndërrojnë vendin pa lejen e administruesit.
-  Të kopjojnë në asnjë lloj forme;
-  Të përshpëritin apo të komunikojnë me të tjerët, në asnjë llojë forme;
-  Të dëmtojnë Fletëpërgjigjen, apo broshurën e testit;
-  Të pengojnë të tjerët gjatë kohës së testimit.




Maturantët që nuk u përmbahen këtyre rregullave, do të largohen nga Provimi i Maturës.

UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E FLETËPËRGJIGJES:

Të gjitha shënimet e kërkuara duhet të barten në fletëpërgjigje, si p.sh. Në rubrikën KODI I IDENTIFIKIMIT duhet shënuar kodin e komunës, kodin e shkollës e kështu me radhë

MËNYRA E PLOTËSIMIT TË FLETËPËRGJIGJES:



Në Broshurën e testit janë kërkesat (pyetjet) me nga katër alternativa prej të cilave vetëm njëra është e saktë. Përgjigjen që mendoni se është e saktë duhet rrethuar në test dhe të njëjtën duhet bartur në fletëpërgjigje

Shembull: Kërkesa e testit 14: Është dhënë vargu i numrave:
1, 3, 7, 15, 31, ... Cili është numri vijues në vargun e dhënë?

- A. 67
- B. 65
- C. 63
- D. 61

Alternativa C është e saktë. E rrethoni atë në test dhe të njëjtën e ngjyrosni me laps grafit në fletëpërgjigje, në këtë mënyrë: 14 A B ● D

Përndryshe, do të konsiderohet gabim nëse plotësohet në formë tjetër, si p. sh.:

14 ● B ● D | 14 A ● C ● D

Duhet pasur kujdes që, përgjigjen e saktë të një kërkesë të mos e vendosim mbi kërkesën tjetër. Duhet pasur kujdes që hijezimi i shënimeve të jetë i plotë

Plotësoni me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha të dhënat.

Çdo pyetje e saktë vlerësohet me pikë, ndërsa çdo pyetje e pasaktë vlerësohet me zero pikë (0).

Lexoni me kujdes kërkesat –pyetjet e pastaj shënoni vetëm njërin nga katër përgjigjet që konsideroni se është e saktë.

Përgjigjen e saktë e plotësoni në Broshurën e testit dhe, njëkohësisht e bartni në Fletpërgjigje.

Fletëpërgjigjja plotësohet vetëm me laps të grafit.

Kini kujdes gjatë mbushjes dhe bartjes së përgjigjeve nga broshura e testit në Fletërgjigje, sepse vetëm Fletpërgjigjet lexohen, krahasuar me Broshurën e testit.

P.sh: Nëse në test, për pyetjen numër 1 keni konsideruar se alternativa C është e saktë, atëherë edhe në Fletëpërgjigje e plotësoni alternativën C.

Poashtu, nëse për pyetjen numër 2 konsideroni se përgjigja e saktë është alternativa B, edhe në Fletëpërgjigje e plotësoni alternativën B. Shih figurën: 1 A B ● D
2 A ● C D

Pikë negative nuk ka.

Nuk duhet plotësuar në këtë mënyrë: 1 A B ● C D

Mos i plotësoni dy alternativa, sepse nuk do të lexohet asnjëra dhe nuk do të merrni asnjë pikë!

Llogaritjet apo ndonjë shënim tjetër mund t'i bëni në Broshurë të testit e assesi në Fletpërgjigje.

Lapsat me ngjyrë nuk lexohen nga "Lexuesi Optik"

KOMISIONI QENDROR SHETËROR I MATURËS

Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës (KQSHM) është emëruar nga Ministri i Arsimit, Shkences dhe Teknologjisë, konform Ligjit nr.03/L – 018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore.

Mbështetur në ligjin në fjalë, KQSHM është organ mbikqyrës, këshillues dhe vendimarrës për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me organizimin e maturës shtetërore.

KQSHM miraton komisionet që kanë për detyrë të përpilojnë pyetjet, miraton katalogun e lëndëve duke u bazuar në programet mësimore të profileve përkatëse, si dhe përcakton Programet Orientuese për Provimin e Maturës Shtetërore.

KQSHM miraton rezultatet përfundimtare të përpunuara nga DVSM dhe i publikon ato.

KQSHM harmonizon afatin e publikimit të rezultateve me afatin e shpalljes së konkurseve për regjistrim në Arsimin e Lartë.

Këtë vit, maturantët do ti nënshtrohen provimit të maturës për dy ditë në një afat.

Në ditën e parë do të jenë 120 pyetje nga lëndët e përgjithëshme (Gjuhë amtare, Gjuhë angleze dhe Matematikë), ndërsa në ditën e dytë do të jenë 80 pyetje nga lëndët më të afërta me profilin e shkollës së përfunduar. Rezultatet e ditës së parë dhe të dytë do të jenë kusht për pranim tuaj për studime në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Mbani mend ! _____ **Nehat Mustafa – Kryetar i KQSHM**

- Paraqitja e Provimit të Maturës Shtetërore më **14-31 maj**
- Mësimi për maturantë përfundon më **18 maj 2012**
- Provimi i Maturës Shetërore, Dita e parë, më **9 qershor 2012**
- Provimi i Maturës Shetërore, Dita e dytë, më **23 qershor 2012**
- Publikimi i rezultateve, më **30 qershor 2012**
- Paraqitja e Provimit të Maturës Shtetërore, më **20 – 23 gusht 2012**
- Provimi i Maturës Shetërore, Pjesa e parë, më: **31 gusht 2012**
- Provimi i Maturës Shetërore, Pjesa e dytë, më: **8 shtator 2012**
- Publikimi i rezultateve, më **17 shtator 2012**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



QEVERIA E KOSOVËS
VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU



9&23

QERSHOR

MATURA SHTETËRORE 2012

**31 Gusht
8 Shtator**

Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës